REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK

Maliq, më 14.05.2026

DEKLARATË PUBLIKE

E TITULLARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK MALIQ

"Për Përmirësimin e Transparencës dhe Rritjen e Besimit Publik"

Në funksion të forcimit të qeverisjes vendore, rritjes së besimit të qytetarëve dhe garantimit të një administrimi sa më të hapur e të përgjegjshëm, Këshilli Bashkiak Maliq angazhohet publikisht për përmirësimin e vazhdueshëm të transparencës institucionale dhe komunikimit me qytetarët.

Transparenca përbën një nga shtyllat kryesore të një administrate moderne dhe efektive. Për këtë arsye, Këshilli Bashkiak do të ndërmarrë masa konkrete për publikimin në kohë reale të vendimeve dhe akteve të miratuara nga Këshilli Bashkiak rritjen e aksesit të qytetarëve në informacionin publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi zhvillimin e konsultimeve publike për çështje me interes për komunitetin përmirësimin e komunikimit institucional me qytetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit, forcimin e mekanizmave monitorues dhe të kontrollit për garantimin e llogaridhënies përdorimin më të gjerë të platformave elektronike dhe mjeteve digjitale për informimin e publikut.

Gjithashtu, do të punohet për rritjen e standardeve të integritetit institucional, etikës administrative dhe pjesëmarrjes qytetare në proceset vendimmarrëse, me qëllim krijimin e një administrate më të hapur, më të përgjegjshme dhe më pranë qytetarëve.

Këshilli Bashkiak Maliq mbetet i angazhuar për të garantuar një qeverisje vendore transparente, gjithëpërfshirëse dhe në shërbim të interesit publik.

KRYETARI I KËSHILLIT
Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ